

# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shkurt

## 2024

mars 2024

Action for  
Democratic Society  
[hibrid.info](http://hibrid.info)



# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shkurt

**Publikues:** ADS/hibrid.info

Prishtinë, mars 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



# Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

# Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit shkurt 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i njëzetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

# Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Gjatë muajit shkurt janë trajtuar 60 përmbajtje keqinformuese të publikuar në media reale, portale të dyshimta dhe llogari e faqe në mediat sociale. Në kuadër të këtyre 60 përmbajtjeve, kanë dominuar artikujt clickbait me 25%, pasuar nga dezinformata me 13% dhe manipulimi i fakteve me 12%.

Përderisa gjatë muajit janar (2024) kanë dominuar dezinformatat për tema të ndryshme sociale, përfshirë këtu edhe ato për largimin masiv të popullsisë pas liberalizimit të vizave, gjatë shkurtit kanë dominuar artikuj clickbait kryesisht për raste tragjike dhe tema të tjera sociale e politike. Në situatat kur nuk kemi ndonjë zhvillim që e merr përqendrimin kryesor, apo kur kemi zhvillime me peshë më të vogël, në klasifikimin e përmbajtjet keqinformuese rikthehet në pozitën e parë kategoria clickbait për tema kryesisht tragjike (vdekje e vrasje).

Kjo kategori, pasohet nga dezinformata, si një nga format më të shpeshta të keqinformatave të publikuara. Dezinformatat përkundër që kanë pësuar rënie krahasuar me muajin paraprak (26% në janar, 13% në shkurt), ato radhiten si e dyta gjatë këtij muaji (shkurt). Këto dy kategori vlerësuese për keqinformata, janë format më të shpeshta të keqinformimit, e që reflekton edhe në raportet ku shpesh radhiten si të parat në klasifikim.

Në vendin e tretë, radhitet manipulim i fakteve si rezultat i disa përmbajtjeve të manipuluar e të publikuara për disa tema politike dhe sociale, kryesisht që e kanë karakterizuar muajin.



25% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “clickbait”.

# Analizë e llojeve të vlerësimeve

# 1.1

## 01. Clickbait

Keqinformatat të cilat janë vlerësuar si “Clickbait” janë publikuar kryesisht në portale informative. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre përmbajtjeve “clickbait” janë publikuar nga fusha e kronikës së zezë. Në kuadër të këtyre përmbajtjeve, tema e rasteve tragjike ka dominuar si rezultati asaj se këto përmbajtje nxisin klikimin e audiencës. Por, nuk kanë munguar edhe artikuj clickbait rreth temave ndërlidhur me largimin e popullsisë pas liberalizimit të vizave, dialogun Kosovë-Serbi, gjykatën speciale dhe tema të tjera.

## 03. Manipulim i fakteve

Publikimet keqinformuese që kanë përmbajt në vete manipulim të fakteve janë publikuar në media reale (8%) dhe në media sociale (3%). Pothuajse të gjitha këto përmbajtje të manipuluar janë nga fusha e politikës, përjashto këtu një përmbajtje nga fusha e sigurisë. Përderisa përmbajtja e manipuluar nga fusha e sigurisë, ndërlidhej më temën e armatosjes së FSK-së, ndërsa nga fusha e politikës i manipuluan përmbajtjet për vendimin e BQK-së për dinarin, raportet Kosovë-Serbi, partneritetin Kosovë-SHBA etj.

## 02. Dezinformatë

Dezinformatat kryesisht janë publikuar në media në gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe faqe e llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Këto dezinformata janë publikuar kryesisht nga fusha e politikës. Në mediat në gjuhën serbe është publikuar një dezinformata ndërlidhur më shtatoren e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, e ngritur në pronë private në një fshat të Podujevës, për të cilën u dezinformua se është ngritur nën dijeninë dhe dëshirën e Kurtit. Në mediat në gjuhën shqipe u publikuan dezinformata lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, rreth sanksioneve ndaj Kosovës nga SHBA-të dhe BE-ja, si dhe rreth vendimit të BQK-së për dinarin. Ndërsa në mediat sociale në gjuhën shqipe u dezinformua rreth punësimit në Zvicër, korrupsionit dhe temave të tjera.

## 04. Përmbajtje e paverifikuara

Përmbajtjet e vlerësuar si të paverifikuara janë publikuar kryesisht në mediat sociale. Pjesa dërrmuese e këtyre përmbajtjeve janë publikuar nga fusha sociale, përjashto këtu një përmbajtje të huaj nga fusha e kurioziteteve dhe një nga fusha e sigurisë. Përmbajtja nga fusha e sigurisë kishte të bënte me zhvillimet në veri, ku pretendohet pa fakte se Policia e Kosovës ka rrahur në prani të fëmijëve një person të nacionalitetit serb. Ndërsa përmbajtjet e paverifikuara nga fusha sociale ndërlidhen me konfliktin Izrael-Hamas, si dhe me diasporën shqiptare.

## 05. Lajm i rremë

Të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në mediat sociale nga faqe dhe llogari në gjuhën shqipe. Lajme të rreme u publikuan nga fusha e politikës, sociale dhe e sigurisë. Nga fusha e sigurisë, lajme të rreme u publikuan lidhur me konfliktin Izrael-Hamas dhe armatosjen e FSK-së, ndërsa nga fusha sociale për diasporën kosovare, e nga fusha e politikës përfshihen deklarata për Albin Kurtin.

## 06. Gabim

Të gjitha publikimet keqinformuese të cilat në vete kanë përmbajtur gabime, janë publikuar në media reale. Gabime pati në përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga fusha e kronikës së zezë, sociale dhe sportit. Përderisa nga kronika e zezë u raportua gabimisht për një rast tragjik dhe numrin e të arrestuarve për trafikim të mjeteve eksplozive, nga fusha sociale u raportua gabimisht rreth shumës së eurove të falsifikuara, dhe nga fusha e sportit për parakualifikimet për Kupën e Botës në basketboll.

---

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: mashtrim, teori konspirative, clickbait/dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar/satirë, clickbait/teori konspirative, dezinformatë/clickbait, clickbait/përmbajtje e paverifikuar dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë.




# Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Ashtu si në muajin paraprak (janar 2024) edhe gjatë muajit shkurt (2024), tema kryesore që ka mbizotëruar në përmbajtjet e trajtuara janë rastet e ndryshme tragjike (vdekje, vrasje). Shumëllojshmëria e temave nga fusha politike dhe sociale, për të cilat u keqinformua u publikuan në media reale, portale të dyshimta dhe media sociale, ka bërë që përmbajtjet e koduara si raste tragjike (vdekje e vrasje) të mbizotërojnë gjatë këtij muaji.

Publikimet e rasteve tragjike të vlerësuara si “clickbait” edhe pse patën rënie të lehtë në përqindje krahasuar me muajin e kaluar, ato e dominuan ekosferën keqinformuese me arsyetimin se publikues të ndryshëm përdorën ngjarje të këtij lloji nga vende të ndryshme, me synimin që, duke mos e përcaktuar vend-ngjarjen përmes titullit, t’i paraqesin ato si ngjarje që kanë të bëjnë me Kosovën apo vendet shoqëpfolëse.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), më 17 janar të këtij viti njoftoi se “Rregullorja e Re për Operacionet me Para të Gatshme” ishte miratuar më 27 dhjetor, 2023, ndërsa do të hynte në fuqi më 1 shkurt, 2024. Kjo nxiti reagime e diskutime të shumta, por edhe u përdor edhe për keqinformim. Si rezultat i kësaj, përmbajtjet e ndërlidhura me vendimin e BQK-së për dinarin, radhitet si e dyta, sa i përket temave.

Ashtu si në muajin janar (2024), edhe gjatë muajit shkurt (2024) zhvillimet brenda vendbanimeve serbe kanë qenë temë e cila është përdor për keqinformata. Ndërlidhur me disa zhvillime të caktuara në vendbanimet serbe, e për të cilat u pretendua pa fakte, ka bërë që kjo temë të radhitet si e treta.

Gjatë janarit ka pasur keqinformim lidhur me tema si: konfliktit Izrael-Hamas, kushte klimatike, veriu, raportet Kosovë-Serbi, etj.



40% e temave kryesore janë për raste të ndryshme tragjike, vendimi i BQK-së për dinarin, incidente në vendbanimet serbe, konfliktin Izrael-Hamas, kushtet klimatike dhe veriu.

# Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

## 2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

### 01. Raste tragjike (vdekje, vrasje)

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese nga kjo temë janë nga fusha e kronikës së zezë e që janë publikuar kryesisht në media. Pothuajse të gjitha janë vlerësuar si “clickbait”. Artikujt në kuadër të kësaj teme të keqinformimit kanë trajtuar raste tragjike si vdekje e vrasje në rrethana të ndryshme dhe për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes duke pasur parasysh se ngjarjet kanë ndodhur jashtë hapësirave shqipfolëse.

### 03. Vendbanimet serbe

Përmbajtjet keqinformuese ndërlidhur me incidentet në vendbanimet serbe janë vlerësuar si teori konspirative dhe janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe bazuar në komunikatat e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Të gjitha këto përmbajtje ishin nga fusha sociale, ku plaçkitjet apo incidentet në vendbanimet serbe, Zyra i interpreton pa fakte se veprimi është bërë me qëllim të dëbimit të serbëve, edhe pse nuk dihen kryesit e veprës dhe qëllim i tyre.

### 02. Vendimi i BQK-së për dinarin

Përmbajtjet keqinformuese që ndërlidhen me vendimin e BQK-së për dinarin janë publikuar në media dhe media sociale, të cilat janë vlerësuar si manipulim i fakteve (3%), mashtrim (2%) dhe dezinformatë (2%). Këto përmbajtje u publikuan nga fusha e politikës dhe sociale. Nga fusha e politikës u pretendua se Franca e ka cilësuar provokim vendimin e BQK-së, se Kosova do ta pësoj keq pas këtij vendimi, si dhe deklaratë e pathënë nga Kurti se “unë pyes Bankën e Kosovës, jo SHBA-të”.

### 04. Veriu


Përmbajtjet keqinformuese për zhvillimet në veri janë publikuar në portale të dyshimta në gjuhën shqipe dhe media sociale (telegram) në gjuhën serbe. Përmbajtja në gjuhën shqipe është vlerësuar si dezinformatë ku pretendohet rrejshëm se dje kanë ndodhur tri shpërthime të fuqishme në Veri. Ndërsa, në gjuhën serbe është publikuar përmbajtje e paverifikuar ku pretendohet pa fakte se Policia e Kosovës ka rrahur në prani të fëmijëve një person të nacionalitetit serb dhe teori konspirative me pretendimin pa fakte se “shërbimet e sigurisë së Kosovës” kanë shpërndarë fletushka në Veri me thirrje për mos bindjen ndaj Policisë së Kosovës.

## Llojet e fushave

Rezultatet e monitorimit për muajin shkurt 2024 tregojnë se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës. Pasi që, fusha e politikës në muajt e fundit nuk zinte vend në mesin e tre fushave kryesore, gjatë muajit shkurt (2024) më së shumti përmbajtje keqinformuese kishte nga fusha e politikës.

### FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Krahasuar me muajt e kaluar, fusha e politikës gjatë muajit shkurt ka dominuar sa i përket përmbajtjeve keqinformuese të publikuara. Sa i përket muajve tjerë, politika është radhitur kryesisht pas tre kategorive kryesore. Por që, gjatë këtij muaji (shkurt 2024), një shumëllojshmëri temash për të cilat u keqinformua ishin nga fusha e politikës, si rezultat i së cilës kjo fushë radhitet si e para. Fusha e politikës pasohet nga ajo e sociale, e cila ka pësuar rënie krahasuar me muajin paraprak (nga 43% në muajin janar 2024, në 24% në muajin shkurt 2024). Këto dy fusha përbëjnë gati gjysmën e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara në këtë muaj.


Këto dy fusha pasohen nga fusha e sigurisë, e cila ka pësuar rënie të lehtë krahasuar më muajin paraprak (nga 22% në muajin janar 2024, në 18% në muajin shkurt 2024). Fusha e sigurisë, pasohet nga kronika e zezë, e cila mbetet në përqindje të njëjtë si në muajin paraprak (janar 2024).

Pothuajse të gjitha përmbajtjet nga fusha e politikës janë publikuar në gjuhën shqipe, përfshirë në media (20%) dhe media sociale (7%). Sa i përket vlerësimit kategorizues të këtyre përmbajtjeve, prijnë manipulimi i fakteve (10%), dezinformata (8%) dhe clickbait (3%). Për një mori temash nga politika janë publikuar përmbajtje keqinformuese, në mesin e të cilave dominojnë vendimi i BQK-së për dinarin dhe dialogun Kosovë-Serbi.

Përmbajtjet keqinformuese nga fusha sociale janë publikuar në media sociale (13%) dhe media reale (7%). Mashtrim, përmbajtje e paverifikuar dhe clickbait/dezinformata janë tri kategoritë kryesore me të cilat janë vlerësuar keqinformatat e publikuara nga kjo fushë. Diaspora shqiptare, konflikti Izrael-Hamas dhe vendimi i BQK-së për dinarin janë temat mbi të cilat u keqinformua më së shumti në aspektin social, e që nuk mungojnë edhe temat si: rritja e pensioneve, dhënie kredish, falsifikimi i 2 eurove etj.

Sa i përket fushës së sigurisë, veriu, vendbanimet serbe dhe armatosja e FSK-së janë tri temat kryesore mbi të cilat u keqinformua. Përmbajtje keqinformuese nga fusha e sigurisë janë publikuar kryesisht në media reale (8%) dhe media sociale (8%), e që janë vlerësuar kryesisht si teori konspirative (7%), lajm i rremë (3%) dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformata (2%).

Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të kronikës së zezë janë vlerësuar “clickbait”(12%) lidhur me raste tragjike si vdekje dhe vrasje në rrethana të ndryshme. Të gjitha këto përmbajtje janë publikuar në media reale (12%) dhe media sociale (3%).



82% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sociale, sigurisë dhe kronikës së zezë.

# Llojet e publikuesve



4

Në bazë të gjetjeve dhe trajtimeve të përmbajtjeve keqinformuese del që numri më i madh i keqinformatave janë publikuar në media reale (56%). Krahasuar me muajin paraprak, shihet një rritje e konsiderueshme e publikimeve keqinformuese në mediat reale (nga 40% në janar 2024, në 56% në muajin shkurt 2024), duke bërë kështu që të radhitet e para. Së fundmi në muajin shtator kishin dominuar përmbajtjet e publikuara në media reale. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se të gjitha keqinformatat e vlerësuara “clickbait”, një pjesë e konsiderueshme e manipulimit të fateve dhe dezinformatave, si dhe gabimeve janë publikuar në media reale (në gjuhën shqipe dhe serbe).

Nga ana tjetër, 41% e artikujve për këtë muaj janë publikuar dhe shpërndarë nga publikues në mediat sociale, në të cilat kanë dominuar përmbajtjet e paverifikuara, lajmet e rreme dhe mashtrimet. Ndërsa, vetëm 3% janë publikuar nga portale të dyshimta.

Siç shihet, në krahasim me muajin janar 2024, publikimet keqinformuese në mediat reale, gjatë muajit shkurt 2024, kanë shënuar një rritje, ato në mediat sociale kanë pësuar rënie, ndërsa edhe në portale të dyshimta vërehet rënie prej 5%.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES  
TË PUBLIKUESVE ME  
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




97% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media reale (56%) dhe në mediat sociale (41%).

## Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformatat në gjuhën shqipe të publikuara në media, portale të dyshimta dhe faqe e llogari në mediat sociale, si rezultat i së cilës gjatë muajit shkurt 2024, publikimet në këtë gjuhë mbizotërojnë në trajtim me 90%.

Ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale, si dhe ato media sociale “telegram”, lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës dhe trajtohen pikërisht ato përmbajtje. Në kuadër të muajit shkurt 2024, janë publikuar disa përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me incidente në vendbanimet serbe dhe zhvillime në veri, duke përbërë kështu 10% të gjetjeve dhe trajtimeve të realizuara.

# Analiza e artikujve të kësaj kategorie

## 5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

### 01. Publikimet në gjuhën shqipe

Gati gjysma e keqinformatave të trajtuara në gjuhën shqipe janë publikuar në media reale (48%), ndërsa pjesa tjetër në mediat sociale (37%) dhe portale të dyshimta (3%). Gjatë këtij muaji, kanë mbizotëruar artikujt e vlerësuar si clickbait, manipulim i fakteve dhe gabim, të cilat janë publikuar në media, ku kanë dominuar fusha e kronikës së zezë dhe politikës.

### 02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe janë publikuar në media reale (7%) dhe media sociale (3%). Publikimet e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar si teori konspirative (7%), dezinformatë (2%) dhe përmbajtje e paverifikuar (2%). Përderisa teoritë konspirative kishin të bënin me incidentet në vendbanimet me shumicë serbe dhe pretendimin pa fakte se “shërbimet e sigurisë së Kosovës” kanë shpërndarë fletushka në Veri me thirrje për mos bindjen ndaj Policisë së Kosovës, përmbajtja e paverifikuar ndërlidhej me pretendimin pa fakte se Policia e Kosovës ka rrahur në prani të fëmijëve një person të nacionalitetit serb, ndërsa dezinformata me pretendim të pa bazë se shtatorja e Albin Kurtit në pronë private në një fshat të Podujevës është ngritur nën dijeninë dhe dëshirën e Kurtit.

## Llojet e mediave sociale


Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Sa i përket publikimeve keqinformuese në media sociale, gjatë shkurtit, 83% e përmbajtjeve janë publikuar në Facebook, 10% në TikTok dhe 7% në Telegram.

Ashtu si në muajin paraprak (janar 2024) edhe gjatë këtij muaji (shkurt 2024) mbizotërojnë keqinformatat e publikuara në Facebook duke shënuar rritje prej 17%. Ndërsa keqinformatat në TikTok kanë pësuar rënie krahasuar me muajin e kaluar (janar 2024) prej 21%.

Krahas këtyre dy platformave, gjatë shkurtit janë publikuar edhe dy përmbajtje keqinformuese në gjuhën serbe në median sociale Telegram, e që në tërësi përbënë 7% të përmbajtjeve të publikuara në mediat sociale.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE






# Llojet e publikuesve në mediat sociale

## 6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Përmbajtjet e gjetura dhe trajtuara në mediat sociale për muajin shkurt 2024 më së shumti u publikuan në faqe të ndryshme në Facebook (51%), pasuar nga llogari në TikTok (31%). Krahas kësaj, 11% e përmbajtjeve u publikuan nga faqe të mediave në Facebook dhe 3% nga llogari në Facebook dhe Telegram.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



# Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

## 01. Facebook

Manipulimi i fakteve (17%), clickbait/dezinformatë (14%) dhe mashtrimet (10%) janë kategoritë me të cilat më së shumti janë vlerësuar keqinformatat e publikuara në Facebook. Shumica e këtyre përmbajtjeve keqinformuese janë nga fusha e sociale (28%), pasuar nga politika (21%) dhe kronika e zezë (10%). Në shumësinë e temave të cilat janë përdor për të keqinformuar në Facebook, mbizotërojnë konflikti Izrael-Hamas (10%), raste tragjike (7%) dhe vendimi i BQK-së për dinarin (7%).

## 02. TikTok


Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuara në TikTok janë kategorizuar si lajm i rremë (7%) dhe mashtrim (3%). Të gjitha këto përmbajtje janë nga fusha e politikës (3%), sociale (3%) dhe sigurisë (3%). Armatosja e FSK-së, vendimi i BQK-së për dinarin dhe deklarata lidhur me kryeministrin Kurti, janë temat për të cilat u keqinformua në TikTok.

## 03. Telegram

Një teori konspirative dhe një përmbajtje e paverifikuar në gjuhën serbe janë publikuar nga llogari në median sociale, Telegram. Këto përmbajtje janë nga fusha e sigurisë ndërlidhur me zhvillimet në Veri, përfshirë pretendimet pa fakte se “shërbimet e sigurisë së Kosovës” kanë shpërndarë fletushka në Veri me thirrje për mos bindjen ndaj Policisë së Kosovës dhe pretendimet pa fakte se Policia e Kosovës ka rrahur në prani të fëmijëve një person të nacionalitetit serb.

# Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.




Bazuar në përmbajtjet keqinformuese të trajtuara për muajin shkurt 2024, në mesin e të cilave vetëm në tetë prej tyre janë përfolur institucionet, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë është institucioni më i përfolur. Ky institucion u përfol nga mediat në gjuhën serbe në tre përmbajtje keqinformuese rreth incidenteve në vendbanimet serbe si vazhdimësi e presionit dhe frikësimit me qëllim të dëbimit të serbëve nga vendbanimet e tyre.

Policia e Kosovës është institucioni i dytë më i përfolur në kontekst me institucionet tjera. Ky institucion i sigurisë u përfol nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë në përmbajtjet keqinformuese ku pretendohet pa fakte se Policia e Kosovës ka rrahur në prani të fëmijëve një person të nacionalitetit serb, si dhe në përmbajtje keqinformuese ku pretendohet pa fakte se “shërbimet e sigurisë së Kosovës” kanë shpërndarë fletushka në Veri me thirrje për mos bindjen ndaj Policisë së Kosovës.

Të gjitha institucionet tjera janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në media, portale të dyshimta dhe media sociale.

## RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFORUR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në kontekst me personalitete tjera, në 21 përmbajtje keqinformuese ku janë përfolur personalitetet. Kurti vetëm u përfol në tema të ndryshme politike përfshirë këtu dialogun Kosovë-Serbi, vendimin e BQK-së për dinarin, rreth shtatores së tij të ngritur në pronë privatë në një fshat të Podujevës, etj.

Kurti u përfol edhe në kontekst me personalitete tjera, përfshirë këtu pretendimin e rremë se shkrimtari i njohur, Ismail Kadare të ketë thënë se “të jesh kundër Albin Kurtit sot, si të ishe kundër Adem Jasharit më 1998!”, dhe manipulimin e deklaratës së presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka deklaruar se nuk do ta lejojë Kurtin ta kontrollojë Maqedoninë e Veriut, duke fituar mbi Ali Ahmetin.

Volodymyr Zelensky, presidenti i Ukrainës, është figura e dytë më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në muajin shkurt. U publikuar një video deepfake ku pretendohet se është Zelensky duke vallëzuar. Po ashtu, u publikua në media përmbajtje e paverifikuara ku shpërndahet përmbajtja e llogarisë satirike në emrin e Zelensky-t, me pretendimin se në Tiranë do të diskutohet edhe për çështjen e Kosovës.

Të gjithë personalitet tjera, janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara gjatë muajit shkurt.



# Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

## RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE

### Deklaratë të paqëndrueshme

#### Infrastrukturë

#### Rregullimi i rrugës Prishtinë- Gjilan

Përparim Rama

Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit dhjetor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar një deklaratë.

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama ka publikuar (7 shkurt) projektin që ndërlidhë Arbërinë me Pallatin e Rinisë dhe Hotelin Grand. Kryetari Rama në paraqitjen fillestare të këtij projekti gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, kishte premtuar se ai do të realizohej brenda tre viteve. Pas hulumtimit të hibrid.info, janë gjetur dallime ndërmjet projektit të premtuar në fushatën e zgjedhjeve lokale të vitit 2021 dhe atij të prezantuar me datë 7 shkurt.

# Metodologjia

---

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 29 shkurt 2024, në të cilën janë trajtuar 60 përmbajtje keqinformuese.

---

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit shkurt 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Në bazë të 60 përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë muajit shkurt 2024, artikujt clickbait (25%) janë ato që kanë mbizotëruar, duke u pasuar nga dezinformata (13%) dhe manipulimi i fakteve (12%). Në raste kur nuk kemi ndonjë zhvillim që e merr përqendrimin kryesor, në klasifikimin e përmbajtjet keqinformuese rikthehet në pozitën e parë kategoria clickbait për tema kryesisht tragjike (vdekje e vrasje). Kjo kategori pasohet nga dezinformatat të cilat u publikuan lidhur me tema të ndryshme politike. Edhe përmbajtjet keqinformuese të cilat janë vlerësuar si manipulim i fakteve, e që janë radhitur si të tretat, janë publikuar për tema të ndryshme politike.

---

Artikujt në kuadër të temës si raste tragjike e që kanë trajtuar vdekje, vrasje, aksidente dhe fatkeqësi në rrethana të ndryshme apo edhe tema të ndryshme sociale, për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes apo titujt janë çorientues me synim për të nxitur klikime nga lexuesit, e të cilat kryesisht janë vlerësuar si “clickbait” dhe janë publikuar në portale informative, janë ato që kanë mbizotëruar gjatë muajit shkurt 2024. Gjatë këtij muaji, janë publikuar edhe disa keqinformata lidhur me vendimin i BQK-së për dinarin në kuadër të së cilës janë publikuar disa manipulime të fakteve dhe dezinformata, e që janë publikuar kryesisht në media ku u pretendua se Franca e ka cilësuar provokim vendimin e BQK-së, se Kosova do ta pësoj keq pas këtij vendimi, si dhe deklaratë e pathënë nga Kurti se “unë pyes Bankën e Kosovës, jo SHBA-të”. Incidentet në vendbanimet serbe është tema e tretë e cila është përdorur më së shumti për të keqinformuar, duke iu referuar komunikatave të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, e cila pretendon pa fakte se këto incidente bëhen me qëllim të dëbimit të serbëve nga vendbanimet e tyre.

---

Sa i përket fushave, politika është ajo e cila ka mbizotëruar gjatë muajit shkurt me 27%, pasuar nga socialja me 20% dhe siguria me 18%. Një pjesë e konsiderueshme nga fusha e politikës janë vlerësuar si manipulim i fakteve dhe dezinformata, e që janë publikuar në media, duke dominuar tema e vendimit të BQK-së për dinarin, pasuar nga një mori temash tjera nga politika. Ndërsa nga fusha sociale janë publikuar keqinformata përfshirë tema të ndryshme si diaspora kosovare, rritja e pensioneve, falsifikimi i valutës 2 euro etj, e që janë vlerësuar kryesisht

mashtim dhe përmbajtje e paverifikuar, dhe pjesa dërrmuese e tyre janë publikuar në media sociale. Sa i përket fushës së sigurisë, keqinformata lidhur me këtë fushë janë publikuar në media reale (8%) dhe media sociale (8%) e që një pjesë prej tyre janë vlerësuar si teori konspirative dhe lajm i rremë ndërlidhur me incidentet në vendbanimet serbe dhe zhvillime në veri.

---

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur në kontekst me personalitete tjera, në tema të ndryshme politike përfshirë këtu dialogun Kosovë-Serbi, vendimin e BQK-së për dinarin, rreth shtatores së tij të ngritur në pronë private në një fshat të Podujevës, etj. Volodymir Zelensky, presidenti i Ukrainës, është figura e dytë më e përfolur, në një video deepfake ku pretendohet se është Zelensky duke vallëzuar dhe në shpërndarjen e përmbajtjes së llogarisë satirike në emrin e Zelensky-t, me pretendimin se në Tiranë do të diskutohet edhe për çështjen e Kosovës.

---

Sa i përket kontrollit të deklaratave dhe premtimeve, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, në projektin që ndërlidhë Arbërinë me Pallatin e Rinisë dhe Hotelin Grand, janë gjetur dallime ndërmjet projektit të premtuar në fushatën e zgjedhjeve lokale të vitit 2021 dhe atij të prezantuar me 7 shkurt 2024.



HIBRIDO.INFO